

VENDIM
Nr. 176, datë 29.12.2016

**PËR SHQYRTIMIN E REZULTATIT TË VERIFIKIMIT TË PROKURORISË SË
PËRGJITHSHME PËR FUNKSIONARIN PUBLIK Z. DASHAMIR TAHIRI, DEPUTET
I KUVENDIT TË SHQIPËRISË, NË ZBATIM TË LIGJIT NR. 138/2015, “PËR
GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN, EMËROHEN
OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE”**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 29.12.2016, me pjesëmarrjen e:

Denar Biba	kryetar;
Hysen Osmanaj	zëvendëskryetar;
Bledar Skënderi	anëtar;
Edlira Jorgaqi	anëtare;
Gëzim Veleshnja	anëtar;
Klement Zguri	anëtar;
Vera Shtjefni	anëtare.

Shqyrtoi çështjen me,

OBJEKT: Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme për funksionarin publik z. Dashamir Tahiri, deputet i Kuvendit të Shqipërisë, në zbatim të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

BAZË LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa “a”, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; neni 10, pika 1, germa “d”, neni 15, pika 3, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”; kreu V, pikat 12, 13, 14, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

KQZ-ja pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e të pranishmëve,

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 23, pika 1, germa “a”, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; neni 10, pika 1, germa “d”, neni 14, neni 15, pika 3 të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”; kreu V, pikat 12, 13, 14, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

VENDOSI:

1. Të shpallë të pavlefshëm dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit të deputetit z. Dashamir Tahiri.
2. Ky vendim t’i njoftohet menjëherë Kryetarit të Kuvendit.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim sipas ligjit.

KRYETAR
Denar Biba